



REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
MINISTRIA E KULTURËS  
KËSHILLI KOMBËTAR I TRASHËGIMISË KULTURORE MATERIALE

Nr. 536 Prot.

Tiranë, më datë 19.02.2020

**VENDIM**

**Nr. 57, datë 19.02.2020**

Në mbështetje të Ligjit Nr. 27, datë 17.05.2018 “Për Trashëgiminë Kulturore dhe Muzetë”, neni 38, pika 2, V.K.M Nr. 208, datë 10.04.2019 “Për Përbërjen, Mënyrën e funksionimit, Kompetencat dhe Shpërblimin e Anëtarëve të Këshillit Kombëtar të Trashëgimisë Kulturore Materiale”, pas shqyrtimit më parë të relacionit për varrin e dëmtuar nr. 16 në nekropolin e Amantias, DRTK Vlorë, në Këshillin Teknik të Institutit Kombëtar të Trashëgimisë Kulturore, Këshilli Kombëtar i Trashëgimisë Kulturore Materiale, në mbledhjen e datës 19.02.2020,

**VENDOSI:**

1. Miratimin e relacionit për varrin antik nr. 16 të dëmtuar në nekropolin verilindor të Parkut Arkeologjik Amantia, hartuar nga specialistët e DRTK Vlorë dhe DSHA;
2. Të realizohet gërmimi arkeologjik i shpëtimit, dokumentimi dhe mbulimi i varrit nga nga specialistët e DRTK Vlorë dhe DSHA;
3. Raporti i rezultateve të gërmimit arkeologjik të shpëtimit të paraqitet për shqyrtim dhe vendimarrje në mbledhjen e radhës së KKTKM.
4. Ngarkohet Instituti Kombëtar i Regjistrimit të Trashëgimisë Kulturore për regjistrimin e këtij Vendimi;
5. Ngarkohet Sekretaria Teknike për njoftimin e këtij Vendimi;
6. Ndaj Vendimit mund të ushtrohet ankim në gjykatën kompetente për shqyrtimin e mosmarrëveshjeve administrative. Ankimi nuk pezullon zbatimin e aktit administrativ.

Ky Vendim hyn në fuqi menjëherë.

**SEKRËTAR**

Arta DOLLANI

**KRYETAR**

Elva MARGARITI

